



Datë: 04.02.2026
Numër Protokolli: 616/2026

A.nr.2051/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës– Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Flakron Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, duke vepruar në procedurë sipas ankesës A.nr.2051/2025, të datës 22.12.2025, të parashtruar nga ankuesi J.M, nga Prishtina, kundër organit të punësimit/Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 04.02.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.2051/2025, e datës 22.12.2025 e parashtruar nga ankuesi J.M.

II. Mbetet në fuqi Vendimi Nr.Ref.516/2025 i datës 19.12.2025, i nxjerrë nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, J.M, (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 22.12.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar me numër protokolli 7987/2025, kundër Vendimit Nr.Ref.516/2025 të datës 19.12.2025 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 26.12.2025 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit nga

Ministria e Punëve të jashtme dhe Diasporës (tutje: MPJD), ndërsa kjo e fundit më datë 06.01.2026 ka përcjellë përgjigjen në ankesë bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën e datës 22.12.2025 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e datës 19.12.2025 të Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD-së; Kopjen ID-së së ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 26.12.2026; Përgjigje në ankesë e datës 06.01.2026; Akt Emërimit nr.137/2024 e datës 03.09.2024; Kërkesën e ankuesit të datës 22.08.2025; Vendimin e datës 11.12.2024 të Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD-së; Vendimin e Këshillit A.nr.1788/2025 të datës 24.11.2025.

Kolegji i Këshillit pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e parashtruara të lëndës nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është ***e pabazuar***, sepse:

Nga administrimi i provave të lëndës, Kolegji i Këshillit, ka konstatuar se ankuesi sipas Aktit të Emërimit Nr.137/2024 të datës 03.09.2024 është i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në pozitën “Zyrtar i Lartë Ligjor”, në kuadër të Divizionit për Hartim dhe Harmonizim të Legjislacionit/Departamenti për Çështje Ligjore dhe Traktatet, ndërsa Sekretari i Përgjithshëm MPJD-së, përmes Vendimit Nr.Ref.621/2024 të datës 11.12.2024, ankuesi e ka ngarkuar me detyra dhe përgjegjësi shtesë si zyrtar përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale.

Ankuesi, fillimisht me datë 22.08.2025 kishte parashtruar kërkesë tek Sekretari i Përgjithshëm i MPJD-së, për kompensim financiar lidhur me ushtrimin e detyrave si Zyrtar përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa kërkesën në fjalë e kishte mbështetur duke iu referuar dispozitave të Rregullores Nr.10/2023 për Kompensimin për Funkcionin Shtesë, sipas nenit 4 paragrafi 1, ndërlidhur me nenin 5, paragrafi 2 të rregullores në fjalë, pra nga analizimi i kërkesës në fjalë, ankuesi pretendonte se detyrat me të cilat ishte ngarkuar paraqesin funksion shtesë sipas legjislacionit përkatës për kompensimin në këtë çështje apo fushë të përgjegjësisë.

Tutje, lidhur me kërkesën e tij të datës 22.08.2025 organi i punësimit kishte heshtur, ashtu që ankuesi kishte parashtruar ankesë në Këshill me datë 13.10.2025, ndërsa Këshilli me datë 24.11.2025 përmes Vendimit A.nr.1788/2025 e kishte aprovuara ankesën e ankuesit, ndërsa e kishte detyruar Sekretarin e Përgjithshëm të MPJD-së, që të shqyrtojë kërkesën e ankuesit të datës 22.08.2025.

Me qëllim të zbatimit të Vendimit të Këshillit, Sekretari i Përgjithshëm i MPJD-së, ka shqyrtuar kërkesën e ankuesit të datës 22.08.2025, ashtu që përmes Vendimit të datës 19.12.2025, tani e tutje akti i kontestuar, e kishte refuzuar ankesën e ankuesit për kompensim material me arsyetimin se kërkesa e ankuesit nuk gjen mbështetje ligjore në dispozitat e nenit 5, paragrafi 2 të Rregullores Nr.10/2023 për Kompensimin për Funkcionin Shtesë, ngase nuk plotësohen parakushtet e përcaktuara nga kjo dispozitë, pasi që detyrat dhe përgjegjësitë e funksionit të zyrtarit përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale nuk i ka funksionet e ndonjë bordi apo komisioni përkatës, mirëpo detyrat dhe përgjegjësitë me të cilat

është ngarkuar burojnë nga Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, mbi bazën e të cilave dispozita zyrtari përkatës vepron si pikë kontakti me Agjencinë për Informim dhe Privatësi nga MPJD.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshill kundër aktit të kontestuar, pretendon se akti në fjalë është i paligjshëm ngase është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e aplikuara nga Ligji Nr.08/L-196 për Pagat për Zyrtarët Publik, Ligji Nr.05/L-031 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Ligji Nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe në kundërshtim edhe me vendimin e Këshillit, sikurse ankuesi pretendon se Këshilli përmes vendimit A.nr.1788/2025 e ka aprovuar ankesën e ankuesit si të bazuar, ndërsa akti i kontestuar pavarësisht që iu ka përmbajtur vetëm çështjes së heshtjes administrative nuk ka respektuar edhe kompensimin material sipas vendimit të Këshillit, me kërkesë që Këshilli të miratoi kompensimin e kërkuar material për funksionin shtesë dhe atë në mënyrë retroaktive nga data 11.12.2024, ndërsa të anuloi aktin e kontestuar.

Fillimisht, Kolegji i Këshillit thekson faktin se me Vendimin paraprak A.nr.1788/2025 të Këshillit ankuesit nuk i është njohur e drejta në kompensim, sikurse i njëjti pretendon, ashtu që dispozitivi i vendimit në fjalë është i qartë, ndërsa ankesa e tij është aprovuar në kuptim të mos marrjes së përgjigjes me shkrim apo përmes aktit administrativ sikurse përcaktohet me dispozitat e aplikuara nga neni 98 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ndërlidhur me nenin 11 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 dhe nenin 27 paragrafi 1, i të njëjtit ligj, dhe mbi këtë bazë është detyruar Sekretari i Përgjithshëm i MPJD-së që të shqyrtojë kërkesën e ankuesit si dhe të gjitha pretendimet e tij në kërkesën në fjalë të datës 22.08.2025, ashtu që jo vetëm në dispozitivin e vendimit në fjalë por madje në asnjë pjesë të arsyetimit të Vendimit A.nr.1788/2025 nuk i është konfirmuar e drejta në kompensimin e pretenduar, dhe mbi këtë bazë pretendimi ankimor për këtë çështje i cili pretendon se Këshilli ia ka njohur të drejtën në kompensim përmes vendimit paraprak nuk është i bazuar.

Kolegji i Këshillit me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, fillimisht analizoi përmbajtjen e Vendimit Nr.ref:621/2024 të datës 11.12.2024 të Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD-së, dhe konstatoi se përmes aktit në fjalë ankuesi me datë efektive që nga 11.12.2024 është caktuar në cilësi të Zyrtarit përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale në kuadër të MPJD-së, ndërsa caktimi është bërë sipas obligimeve ligjore që rrjedhin nga dispozitat e aplikuara nga neni 37, 38 dhe 39 i Ligjit Nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, kurse në aktin në fjalë nuk është përcaktuar asnjë lloj i kompensimit, sikurse aktin në fjalë pala ankuese nuk e ka kontestuar, apo thënë ndryshe pala në parim nuk e ka kundërshtuar ushtrimin e kësaj detyra apo përgjegjësie, pavarësisht ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësie që ka sipas Aktit të Emërimit të datës 03.09.2025 si pozitë të rregullt dhe të përhershme në shërbimin civil.

Thënë si më lartë, në kuptim të nenit 38 paragrafi 6 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, Kolegji i Këshillit analizoi kriteret lidhur me përfitimin e pagesës për funksionin shtesë sikurse rregullohet me dispozitat e nenit 5 paragrafi 2 të Rregullores Nre.10/2023 për Kompensimin e Funksioneve Shtesë ku përcaktohet se: *“Përjashtimisht, kompensimi për funksionin shtesë mund të përfitohet kur plotësohen në mënyrë kumulative kriteret e mëposhtme: 2.1. themelimi i Komisionit/Bordit parashihet në ligj apo akt nënligjor; 2.2. përfshirja në komision përbën funksion shtesë për zyrtarin*

publik; 2.3. funksioni nuk bënë pjesë tek detyrat e obligueshme të pozitës të cilën zyrtari publik e mbanë; 2.4. përfshirja në Komision kërkon ekspertizë profesionale të cilën zyrtari e posedon; 2.5. komisionet/bordet të cilat kanë kompetenca Vendim-marrëse në procedurë administrative; 2.6. komisioni/bordi nuk themelohet nga institucioni ku zyrtari publik është i punësuar”, Kolegji i Këshillit erdhi në përfundimin se kjo dispozitë ka përcaktuar në mënyrë të qartë kriteret të cilat duhet të përmbushen në mënyrë kumulative për tu kompensuar në emër të funksioneve shtesë, kurse në rrethanat e rastit konkret këto kriteret apo parakushte ligjore nuk janë plotësuar sikurse detyrat dhe përgjegjësitë me të cilat ankuesi është i ngarkuar në cilësi të Zyrtarit përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave, nuk janë ekuivalente me autorizimet ligjore të komisioneve apo bordeve përkatëse sipas ligjit material për kompensimin për funksionet shtesë, prandaj pretendimet ankimore të ankuesit nuk janë të bazuara dhe për rrjedhojë ankesa e ankuesit është refuzuar si e pa bazuar sikurse në dispozitivin e këtij vendimi.

Mirëpo, përveç tjerash Kolegji i Këshillit thekson faktin se organet përkatëse të punësimit në rrethana të caktuara duhet ta kenë parasysh faktin nëse caktimi i një zyrtari me detyra të tjera përveç atyre të përcaktuara me aktin e emërimit, mund paraqet apo përbën shkak rritjes së vëllimit të punës, nëse për pozita caktuara nuk ka zyrtarë të emëruar që janë përgjegjës për përmbushjen e atyre detyrave dhe përgjegjësi të cilat mund t'i ngarkohen një zyrtari tjetër, me qëllim që detyrat shtesë mos të bartin mbi vetë riskun e shkakut për vështirësi në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi për pozitën që mbajnë me akt emërim në mënyrë të përhershme.

Andaj, nga se u tha si më lartë, pas analizimit dhe shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, si dhe duke marrë për bazë dispozitat e aplikuara të përcaktuara si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankesa e ankuesit nuk është e bazuar, ndërsa akti i kontestuar është nxjerrë në pajtueshmëri me dispozitat e aplikuara me nenin 47 dhe 48 të Ligjit Nr.08/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe dispozitat e aplikuara të Ligji Nr.08/L-196 për Pagat për Zyrtarët Publik, ndërlidhur me nenin 5, paragrafi 2 të Rregullores Nr.10/2023 për Kompensimin për Funksionin Shtesë, dhe si i tillë është lënë në fuqi sikurse është theksuar edhe në dispozitivin e këtij vendimi.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe nenin 132 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hy në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.2051/2025, datë 04/02/2026.

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit, J.M;
- Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës (Sekretarit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore), si dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.